



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **57**

Prishtinë, më 17.11.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Zulfi Merxha, Heset Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi, Ali Lajçi.

Munguan : Zef Morina, Myrvete Pantina, Naim Maloku, Elheme Hetemi, Dragiša Mirić.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : përfaqësuesit e ministrisë së bujqësisë, vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshim/plotësimin e ligjit për Pyje,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Naser Rugova fillimisht uroi që ky komision, në mbledhjen e parë nën udhëheqjen e tij, të ketë punë të mbarë dhe suksese, ndërsa deputetët prezent gjithashtu i uruan suksese në punën e mëtejme, pastaj konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin e ligjit për Pyjet

Në fillim **kryesuesi** kërkoi nga komisioni të deklarohet rreth dy propozimeve nga dy ministritë rreth këtij projektligji, nga MMPH propozimi për nenin 7.1 për fshirjen e fjalisë “**si dhe pyjeve në parqet nacionale në Kosovë**”, dhe propozimi nga MBPZHR e shqyrtuar në mbledhjet e kaluara në këtë komision.

Shefki Zeqiri tha se për propozimin e MMPH është debatuar mjaft shumë në MBPZHR, me ç'rast Qeveria më 2007 ka formuar grupin punues por nuk është gjetur gjuhë e përbashkët me MMPH, propozoi të mbetet ashtu si është dhe ofroi bashkëpunim në këtë drejtim.

Muzafer Luma konstatoi se ende nuk ka Ligj për Parqe i cili duhet ta rregulloi këtë çështje, ndaj nuk mundet ti mbetet barra MBPZHR-së kjo pyetje komplekse, ai pranoi se nuk kanë mundur të mirën vesh me MMPH-në dhe gjithashtu tregoi për disa shembuj në shtetet e rajonit (Bullgaria) ku kanë probleme të natyrës së tillë. Ai tha se MBPZHR nuk mundet me i lënë 70.000 ha pyje pa përkujdesje profesionale, ndaj apeloj të riformulohet propozimi i ministritë së mjedisit ose të mbetet ashtu si është në projektligj.

Naser Rugova kërkoi që dy ministritë bashkë me Qeverinë për këtë çështje të debatojnë dhe ti heqin dilemat ngase komisioni edhe pse ka fuqi ligjore dhe argumente ndoshta nuk ka njerëz profesional për këtë çështje, dmth të rregullohet për të ardhmen një çështje shumë me rëndësi dhe për të mos pas ndërhyrje të kohëpaskohshme, përndryshe komunat shpesh do të bien ndesh me këto dy ministri rreth pyjeve dhe parqeve.

Selvie Halimi përkujtoi komisionin se qysh nga dy legjislaturat e para ministritë shumë mirë e dinë se çfarë kompetencash kanë sa i përket parqeve dhe pyjeve por Kuvendi duhet me i hartua kompetencat e tyre me shkrim (ligj) ekzakt për secilën. Ky komision mundet me fshi këtë fjali që ka kërkuar MMPH por problemet prapë do të mbeten, duhet të hartohet ligji i ri për parqet por nuk do të ishte keq të dëgjohen palët (MMPH dhe MBPZHR) edhe një herë a kanë zgjedhje për këtë problematikë, pastaj vendos komisioni, tha ajo.

Berat Luzha dhe **Heset Cakolli** u pajtuan me propozimin e Selvies sepse si tha z. Cakolli pjesa e pyjeve në parqe duhet të ketë trajtim profesional.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Lidhur me propozimin e MMPH për fshirjen e fjalëve te Ligji për Pyjet- neni 7.1 “...parqet nacionale”, caktohet takimi për dt. 24.11.2009 në orën 13,00 ku do të ftohen ministri i bujqësisë dhe i mjedisit, ndërsa për çështjet tjera që do të diskutohet në këtë takim do të dërgohet shkresa e veçantë dy ministrive për ministrin Vehapi dhe Yagcillar, kur parashihet dreka në restorantin e caktuar në Prishtinë, pas mbledhjes.
2. Kompromisi i këtij komisioni është që MBPZHR duhet të hartoj ligjin e ri për Pyje brenda vitit 2010 ku do të përfshihen dispozitat që përmbajnë ndryshimet e bëra me këtë projektligj : kompetencat e departamentit për pyje, kompetencat e komunave, çështja e zyrave regjionale etj.
3. Lidhur me projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Pyje miratohen amendamentet në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, në fillim shtohet si vijon :

Neni 2, paragrafi 2.1, fshihet pika a), ndërsa tek pikat tjera të këtij neni hiqen shkronjat e vogla duke i standardizuar me ligjet tjera në fuqi.

Amendamenti 2

Neni 8, pas paragrafit 2 shtohet si vijon :

Neni 21.5 në dy paragrafët a) dhe b) fjala “Buxhetin e konsoliduar të Kosovës” zëvendësohet me “Buxhetin e Kosovës”, në paragrafin b) numri 20% bëhet 30%.

Berat Luzha e propozoi ndryshimin në 30% ngase tani komunat kanë kompetenca më tepër, ndaj edhe përfitime duhet të kenë më tepër. Zyrtarët e ministrisë ishin të mendimit se kjo do të jetë një lloj “lazdrimi” për ato komuna që kanë pyje.

Amendamenti 3

Neni 15, pas numrit 38 shtohet “dhe 39”.

Amendamenti 4

Neni 12, pas paragrafit 29.11 shtohen paragrafet si vijon :

29.12 Mbrojtja e pyjeve si kompetencë delegohet nëpër komuna :

- a) shërbimi i mbrojtjes së pyjeve në tërësi në pajtim me nenin 29.1, 29.2, dhe 29.3 të kapitullit VIII të ligjit për Pyjet e Kosovës kalojnë si kompetencë komunale,
- b) konfiskimi i masës drusore nga shërbimi i mbrojtjes së pyjeve në komuna, është e hyrë e komunës dhe procedohet në pajtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik të Kosovës,
- c) komunat janë të obliguara që së paku një herë në vit të kryejnë regjistrimin e terreneve dhe të dërgojnë raport me shkrim autoritetit kompetent që menaxhon me pyje,
- d) shërbimi komunal i mbrojtjes së pyjeve është i obliguar që autoritetit kompetent që menaxhon me pyje, t’i dërgojë raporte mujore në fushveprimtarinë e këtij shërbimi,
- e) APK është e obliguar të furnizojë me uniforma shërbimin e mbrojtjes së pyjeve në mënyrë që të janë unike për tërë territorin e Kosovës si dhe me formular unik për mënyrën e raportimit.

29.13 Dhënia e lejeve për shfrytëzimin e masës drusore si kompetencë delegohet nëpër komuna. Gjatë dhënies së lejeve komunat detyrimisht u përmbahen kritereve në vijim:

- a) në bazë të planeve vjetore operaci onale të menaxhimit me pyje, në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Pyjet e Kosovës,
- b) procedurat e dhënies së lejeve duhet të jenë në harmoni me udhëzimet administrative në pajtim me këtë ligj, që rregullojnë këtë çështje të miratuar nga ministria,
- c) inkasimi i të hyrave nga dhënia e lejeve në pajtim me paragrafin a) të këtij neni, derdhen në buxhetin e Kosovës përmes kodit të veçantë komunal i cili përcakton këtë të hyrë si e hyrë nga realizimi i masës drusore,
- d) komunat do të kryejnë shërbimet për përcjelljen e masës drusore, i cili dokumentacion do të sigurohet nga APK me kode të veçanta për secilin komunë. Dizajni dhe forma e këtij dokumentacioni do të jetë unik për tërë territorin e Kosovës,
- e) monitorimi i udhëheqjes së të gjitha këtyre procedurave në pajtim me paragrafët e këtij neni, do të bëhen nga APK.

Të ndryshme

Naser Rugova konstatoi disa çështje për këtë pikë, fillimisht për projektligjin e Shitjes së Banesave, pastaj për propozimin e Afrim Lajçi-t nga ZRRUM për ndryshimin e Ligjit për Mbeturina, fondin e komisionit, disa sugjerime nga përfaqësuesit e Institutit të mjekësisë së punës në Kastriot për projektligjin e “Rrezatimeve Jonizuese” për mosthemelimin e agjencisë pasi që Agjencia ekzistuese për Mbrojtjen e Mjedisit e ka departamentin përkatës (prezantuar nga Berat Luzha) dhe kërkesa e zyrtarëve të MBPZHR rreth projektligjit për OMGJ se ku ka mbetur në procedurën parlamentare.

Komisioni nxori :

K O N K L U D I M

- 1. Caktohet ZEF MORINA anëtarë i këtij komisioni, të kontaktoi me udhëheqësit e Komisionit parlamentar për Komunitete rreth arsyeve të ngecjes së projektligjit për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.**
- 2. Komisioni jap mbështetje Drejtorit të ZRRUM që me propozimet e tij me shkrim të kontaktoj me zyrtarët e MMPH rreth hartimit të ndryshimeve lidhur me Ligjin për Mbeturina.**
- 3. Ky Komision në një mbledhje të veçantë të hartoi planin e shfrytëzimit të fondit financiar të Komisionit për vitin 2010.**
- 4. Nënkryetari Naim Maloku, i cili është ftuar në komisionin për Buxhet për arsyetimin e ekzistimit të agjencisë rreth projektligjit për “Rrezatimet Jonizuese”, do të parashtrori arsyetimin rreth kësaj çështjeje ashtu si është ngarkuar nga ky komision, ndërsa Instituti i mjekësisë së punës në Kastriot hyn në agjendën e këtij komisioni për të bërë vizitën zyrtare atje.**
- 5. Kërkohet nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës sqarim me shkrim për këtë komision arsyet e ngecjes së projektligjit të amendamentuar në këtë komision të Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht.**

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,10. Mbledhja e radhës do të mbahet më 24.11.2009.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova